



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 12, datë 20.11.2024

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: “ZHVILLIM
KOMPLEKS ME FUNKSION REZIDENCIAL, HOTELERI DHE SHËRBIME ME 1-7
KATE MBITOKË DHE 1-3 KATE NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË
DURRËS**

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, e ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Rajfi Group” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Zhvillim kompleks me funksion rezidencial, hoteleri dhe shërbime me 1-7 kate mbitokë dhe 1-3 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës, me zhvillues “Rajfi Group” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 20/01 / 2026